



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:050128

Datë: 23.09.2022

Numri i dokumentit: 03454454

P.nr.998/2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të përgjithshme, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues **Veli KRYEZIU**, me zyrtares Ligjore Fikrije Rexheoi, në lëndën penale kundër të pandehurit **H.H** nga Gjilani, për shkak të veprës penale Shkaktim i rezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5 lidhur me paragrafin I e lidhur me nenin 24 të KPRK-së. të cilin sipas autorizimit e mbron Avokati Sherif Sherifi nga Gjilani , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.48/12 të datës 25.02.2012, të cilën e përfaqësoi prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal dhe publik më datën 24 gusht të vitit 2022, mori dhe në prani të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë, publikisht ka shpallur, ndërsa më datën 23 shtator të vitit 2022 e ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H.H nga i ati H dhe e ëma Z, e lindur M, i lindur në Gjilani, ku dhe jeton ka të kryer fakultetin ekonomik ,i martuar ,baba i dy fëmijve,i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Serbisë, më par i pa denuar dhe nuk udhëheqet procedur për veprë tjeter penale.

Është fajtorë

Sepse :

Me datë 29.01.2012, rreth orës 20.20 min, në ..Gjilani, me dashje së bashku me të miturin F. Sh. A i kanë vu zjarin dy shtëpive të boshatisura, të pronarve të nacionalitetit Serb dhe atë në njëren shtëpi të tani të dëmtuarve ,S. S ,ku është djegur e tërë shtëpia prej tri dhomave, një banjo, një koridori si dhe qatia e shtëpisë si shtëpin e P.S qe te dy si dhe shtëpit e

boshatisura të të dëmtuarit Z.H.nga ... ku më qrast është shkaktu rrezik i përgjithëshëm duke iu shkaktuar dëm thelbsor material.

- **Me qka ka kryer vepren penale**, Shkaktim i rrezikut të përgjithëshëm nga neni 291 par.5 lidhur me paragrafin I e lidhur me me nenin 24 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara si dhe neneve: 4, 7, 21, 38,42,44,69,70 – 71,72 paragrafi 1.3 dhe neni 76 ,të KPRK-së si neni 233 dhe 365 lidhur me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-së), të pandehurin në fjalë

E G J Y K O N

I.Të pandehurit H.H i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej prej njëqind e tetdhjet ditëve 180 ditëve i cili pas shpalljes së aktgjykimit me pëlqimin e të pandehurit,

në kuptim te nenit 44 te KPRK-së

I ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë në shumën prej teteqind(800) Euro, të cilin duhet ta paguaj në dy këste të barabarta , duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

mirëpo nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë,në shumën prej tremij e gjashtëqind (3600) euro, në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s i njëjti **I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim** duke ju llogaritur çdo 20 Euro të gjobës me një ditë burgim,të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve pas marrjes së ftesës nga ana e kësaj gjykate, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II.Në kuptim të nenit 79 paragrafi I të KPRK-ës,të pandehurve H.H nga Gjilani ,në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet koha e qendruar në paraburgim nga data 23.02.2012 e deri më 15.05.2012.

III. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej njezet (20) Eurosecili veq e veq., ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej tridhjetë (30) Euro,secili veq e veq.,të gjitha në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Palet e demtuara ,S.S dhe Z.H për realizimin e kerkeses pasurore juridike udhëzohet ne kontest civilo juridik.

A r s y e t i m

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore – në Gjiilan kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale sipas përkrahimit faktik dhe cilësimit juridik si në dispozitivin e këtij akti akuzues.

Gjykata Themelore në Gjiilan, për këtë lëndë penale sipas rendit të pranimit të lëndëve ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë, më datë 24.gusht2022 ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ndaj të pandehurit **H.H**së bashku me mbrotësin e tij, për shkak të veprave penale si në dispozitiv të aktgjykimit. Po ashtu me datën 23.08.2022, në këtë gjykatë është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjiilan/Departamenti i përgjithshëm në njërën anë dhe në anën tjetër të pandehurit **H.H** , për shkak të veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit, me autorizim e mbron, *Av. Sherif Sherifi*. Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate i është rekomanduar, që ndaj të pandehurit të cekur më lartë për shkak të veprave penale Shkaktim i rezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5 lidhur me paragrafin I e lidhur me me nenin 24 të KPRK-së. , ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 24.08.2022, gjykata pas dëgjimit të palës dhe të mbrojtësit të tij, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk kan qenë në as një mënyrë i detyruar apo i shtrënguar në as një mënyrë të pranon fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston as një nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-se.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri, ka kryer veprat penale Shkaktim i rezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5 lidhur me paragrafin I e lidhur me me nenin 24 të KPRK-së. ,

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratës të palës dhe të mbrojtësit të tij lidhur me dënimet, i ka shpallur fajtor të pandehurin, penale Lendim i leht trupor nga neni 185 par.1.nenpar.1.4,të KPRK-ës, ngase veprimet e të njëjtit i përmbanë të gjitha tiparet e vepres penale dhe se për të njëjtën edhe është penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e kan pranuar edhe vet në marveshjen e lidhur në prokurorin e shtetit.

Neni 291

SHKAKTIMI I RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM (1) Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë e një rëndësie thelbore dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet

(2) Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili në kundërshtim me dispozitat për detyrat e punës së tij nuk i vendos pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, vërshimi, eksplozimi, helmimit ose për mbrojtjen nga gazrat helmuese apo nga rrezatimi jonizues, nga forcat mekanike, nga energjia elektrike ose nga ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji, apo këto pajisje nuk i mirëmban në gjendje të rregullt a nuk i vë në përdorim ose në përgjithësi nuk vepron sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë me vlerë thelbësore dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer në vendin ku është grumbulluar numër i madh i njerëzve, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gobë ose me burgim deri në një vit. (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi apo me dëm material thelbësor, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet, e kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 4 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet, ndërsa kur vepra penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim ashtu siq ishte ne dispozitiv të aktgjykimit,ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, keto dënime do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimeve e të pandehurve, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të akuzuarvet ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan / Departamenti i përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se te pandehurit kan bashkëpunuar me prokurorinë e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se ipandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, e se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë seancës dëgjimore dhe fakti qe nuk ka qenë të dënuar më parë për ndonjë vepër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të akuzuarit me të drejtë mund të pritet që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është rrezikshmëria e veprës penale .

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me gjobë, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 4 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksa për **Kompensimin e Viktimave** në afat prej **pesëmbëdhjetë (15) ditëve**, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.nr. 998/15, më 23.09.2022

Zyrtare ligjore,

Fikrije Rexhepi

Gjyqtari,

Veli KRYEZIU

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

VËREJTJE: Pasi që palët kanë heqë dorë nga e drejta në ankesë, aktgjykimi lëndor bëhet i plotfuqishëm – formës së prerë më datën 24.08.2022.

Numri i lëndës: 2018:050128
Datë: 23.09.2022
Numri i dokumentit: 03454454